

## **Kosova në këndvështrimin e Sigurimit të Shtetit (1945–1991)**

### **Abstrakt**

Ky punim shkencor analizon në mënyrë kritike dhe të kontekstualizuar rolin e aparatit të sigurimit shtetëror në Shqipërinë komuniste në formësimin, kufizimin dhe kontrollin e marrëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës gjatë periudhës 1945–1991. Duke u mbështetur në dokumentacionin arkivor të Autoritetit të Dosjeve – Sigurimit të Shtetit të Shqipërisë, studimi paraqet mekanizmat represivë të regjimit diktatorial, si dhe zbrërthen mënyrën se si logjika e kontrollit autoritar ndërveproi me kontaktet me botën e jashtme, duke përfshirë relacionin me bashkëkombasit e tyre jashtë kufirit, proceset e zhvillimit të entitetit të Kosovës dhe bashkëpunimit institucional në fushat kulturore, shkencore dhe arsimore. Konteksti historik i Luftës së Ftohtë, izolimi ideologjik i Shqipërisë, represioni i pushtetit ndaj vetë popullatës së tij duke shfrytëzuar sigurimin e shtetit, situata politike në Kosovë dhe marrëdhëniet e tensionuara me Jugosllavinë përbëjnë kornizën themelore të këtij studimi.

Argumenti qendror i punimit është se Kosova, në këndvështrimin e Sigurimit të Shtetit, perceptohej në prizmin e qëndrimit zyrtar të regjimit ndaj marrëdhënieve me Jugosllavinë. Ky qëndrim ndryshonte sipas periudhave dhe intensitetit të kundërshtimeve ndaj Beogradit, që nxiste edhe sentimentin kombëtar. Lidhur me bashkëpunimin Shqipëri–Kosovë në vitet '60 deri '80, studimi thekson rëndësinë e madhe të tij për zhvillimin e albanologjisë dhe forcimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar shqiptar, por njëkohësisht i kushtëzuar nga restriksionet jugosllave dhe i deformuar nga aparati i sigurimit shtetëror shqiptar. Ky i fundit trajtonte çdo ndërveprim ndërshtetëror përmes prizmit të dyshimit ideologjik, ruajtjes absolute të pushtetit dhe shtypjes së veprimtarisë dhe ndikimit politik të popullatës. Megjithëse në nivel institucional u realizuan projekte madhore kombëtare—si unifikimi i gjuhës standarde shqipe, bashkëpunimi universitar, shkencor dhe profesional, organizimi i konferencave dhe projekteve historike, gjuhësore, etnologjike, arkeologjike dhe të trashëgimisë kulturore, si dhe simpoziumeve kushtuar figurave dhe ngjarjeve kyçe të historisë kombëtare—këto zhvillime nuk shoqëroheshin me liberalizim në sferën e sigurisë dhe kontrollit politik. Periudha pas demonstratave të vitit 1981 deri në vitin 1991 trajtohet si fillimi i shtypjes sistematike të pavarësisë politike të Kosovës nga ana e Serbisë, duke i dhënë arkivave të sigurimit vlerë të veçantë për kuptimin e marrëdhënieve politike dhe situatës së përgjithshme në Kosovë.

Gjetjet tregojnë se aparati i sigurimit analizonte në aspektin gjithëpërfshirës situatën politike dhe shoqërore në Kosovë duke u bazuar në interesin e mbrojtjes së pushtetit vetanë, si dhe bashkëpunimin ndërshtetëror në nivel institucional, gjersa në nivel personal perceptonte fillimisht çdo kosovar të aratisur në shtetin amë, diasporën shqiptare, inteligjencën kosovare dhe çdo vizitor nga hapësirat shqiptare jashtë kufijve shtetërorë, si kërcënim dhe armik potencial ndaj regjimit. Bashkëkombësit nga Kosova dhe mërgata, të cilët e konsideronin Shqipërinë si “tokën amë dhe të shenjtë” dhe aspironin të vendoseshin aty, nuk u trajtuan me solidaritet kombëtar, por si kërcënim ideologjik dhe politik, duke u ekspozuar shpesh ndaj internimit, burgosjes, rekrutimit të detyruar në sigurimin shtetëror, ose madje eliminimit fizik gjatë tentativave për të hyrë ose arratisur përgjatë kufirit.

Në këto rrethana, çdo vizitor joshtetas u ekspozua ndaj protokolleve standarde të metodave të inteligjencës, përfshirëurvejimin sistematik, ndërtimin joobjektiv të dosjeve personale, etiketime të pabaza, përhapjen e thashethemeve, nxitjen e përçarjeve brenda delegacioneve, përhapjen e dezinformatave dhe veprimeve subversive. Këto të dhëna, të krijuara në një kontekst represiv diktatorial, konsiderohen të pabaza dhe nuk mund të trajtohen si burime objektive për vlerësimin individual, por si produkte të një sistemi ideologjikisht të deformuar.

Metodologjikisht, punimi mbështetet në analizën kritike të burimeve arkivore të sigurimit shtetëror, të kombinuara me literaturën historiografike për Shqipërinë komuniste, Kosovën dhe ish-Jugosllavinë. Artikulli veçon qartë dimensionin institucional nga ai individual, duke treguar se vetëm përdorimi i dokumenteve në nivel struktural dhe ndërinstytucional mundëson një interpretim shkencor të vlefshëm. Risia kryesore qëndron në rivendosjen objektive të dokumentacionit të sigurimit shtetëror në kontekst historik dhe shmangien e riprodhimit të logjikës represive të regjimit. Studimi kontribuon në historiografinë shqiptare duke ofruar një analizë të balancuar të bashkëpunimit Shqipëri–Kosovë si proces real, por të mbikëqyrur dhe të kufizuar nga një sistem diktatorial i mbrojtur me çdo kusht nga sigurimi i shtetit të tij, duke shtuar vlerë për kuptimin e motivacionit lidhur me trajtimin e bashkëkombasve nga Kosova, marrëdhënieve ndërshqiptare, zhvillimin e albanologjisë, pozitës dhe situatës politike në Kosovë dhe dinamikave politike në Ballkan gjatë Luftës së Ftohtë.

**Fjalë kyçe:** Sigurimi shtetëror; Shqipëri–Kosovë; Albanologji; Diktatura; Shërbimi Informativ Kombëtar; Lufta e Ftohtë.